



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1429/1 prot

Datë 04.06.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË

Objekt:	Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Information Business Systems-IBS” Sh.p.k në procedurën e prokurimit “ <i>E Hapur e Thjeshtuar</i> ”, me Nr. REF-46454-04-29-2025 me objekt “ <i>Blerje Trau Elektronik dhe Mirembajtjen e Traut Elektronik ekzistues ne sheshin Gjergj Kastrioti</i> ”, me fond limit 1,744,650 (një milion e shtatëqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.
Ankimues:	Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK me NIPT L01606034A dhe adresë Tirane, Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Parë.
Autoriteti Kontraktor:	Bashkia Lezhë, me adresë: L. Skenderbeg, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhe.
Subjekte të Interesuar:	Operatori ekonomik “Information Business Systems-IBS” Sh.p.k, me NUIS J61820057C, me adresë: Rruga Sali Butka, Pallati Pajtoni, Shk.2, Kati 7, Tiranë.

Në datën 03.06.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1429/2025 protokolli, me datë 03.06.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5376 e operatorit ekonomik “PC STORE” Shpk për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-46454-04-29-2025 me objekt “*Blerje Trau Elektronik dhe Mirembajtjen e Traut Elektronik ekzistues ne sheshin Gjergj Kastrioti*”, me fond limit 1,744,650 (një milion e shtatëqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen

e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Information Business Systems-IBS Sh.p.k”, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime” Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret që “PC STORE” Shpk, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Information Business Systems-IBS Sh.p.k”, në procedurën e mësipërme të prokurimit, të parashtruara në ankesën me 1429/2025, datë 03.06.2025.

Konkretisht në ankesë pretendohet për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Information Business Systems-IBS Sh.p.k” Shpk, të kriterëve si më poshtë vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas *shtojcës 9*;

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

Akoma më tej ankimuesi pretendon se: “Administratori i subjektit Information Business Systems-IBS Sh.p.k” është nën masën e sigurimit personal arrest me burg dhe është në pamundësi objektive për të ushtruar detyrën e administratorit të subjektit IBS, prandaj kemi dyshimin e arsyeshëm që IBS nuk ka paraqitur dokumentat në formën e kërkuar nga ligji në momentin e vlerësimit të dokumentacionit fizik në Autoritetin Kontraktor Bashkia Lezhe dhe as në momentin e paraqitjes së ofertës.”

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, për materialet objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë staf të kualifikuar dhe të figurojë në listpagesa për periudhën Janar 2025- Mars 2025, si më poshtë:

- 1 (një) specialist të certifikuar **nga firma prodhuese e barrieres Elektronike (Cardin Electronic Spa) ose ekuivalente** për montimin apo zëvendësimin e produkteve ku do të kruhet shërbimi i mirembatjes të traut ekzistues.
- Për të provuar disponimin e stafit të kërkuar, OE duhet të paraqesë:
 - a. Listpagesat për periudhën Janar 2025- Mars 2025.
 - b. Çertifikatën përkatëse sipas kërkesave të mesipërme

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues pretendon se; “Operatori ekonomik “Information Business Systems-IBS Sh.p.k”, duhet të dorëzojë dokumentat të cilat paraqesin gjendjen faktike sipas Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumenta jo më të vona se data 12.05.2025. Nisur nga faktet dhe

informacionet e përjavshme të publikuara në Buletinin e Njoftieve Publike, kemi dyshimin e arsyeshëm që operatori ekonomik “Information Business Systems-IBS Sh.p.k” nuk ka paraqitur dokumentat me periudhën e saktë sipas parashikimit nënligjor të sipërcituar.”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 04.06.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro